



Republika e Kosovës - Komuna e Rahovecit- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim  
Republika Kosova – Opština Orahovac- Opštinska kancelarija za zajednice i povratak  
Republic of Kosovo – Municipality of Rahove – Municipal Office for Communities and Return

## Raporti Gjashtëmujor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK)

Periudha: Janar – Qershori 2025  
Komuna: Rahovec

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA RAHOVEC/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC		
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabinet i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 6292 Nr. i faq/Br.str./No.pg 132		
Data/Datum/Date 8 / 7 / 2025		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

### I. Hyrje


Gjatë periudhës Janar–Qershori 2025, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) në Rahovec ka zhvilluar një sërë aktivitetesh dhe iniciativash me synim fuqizimin e komuniteteve jo-shumicë, përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre, promovimin e të drejtave të njeriut dhe mbështetjen e kthimit të qëndrueshëm. Ky raport paraqet një përbledhje të hollësishme të punës së realizuar gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, duke u fokusuar në fushat kyçë të arsimit, infrastrukturës, përfaqësimit institucional, trajnimeve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuese.

## II. Përbledhje e Komponentëve të Zbatimit


### 1. Arsimi

Në bashkëpunim me Organizatën Ndërkontinentale për Migrim (IOM) në Kosovë, ZKKK ka mbështetur realizimin e një projekti të rëndësishëm në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët "4 Dëshmorët" në fshatin Ratkoc. Projekti përfshiu pajisjen dhe furnizimin e kabinetëve të fizikës, kimisë, biologjisë, matematikës dhe gjeografisë me aparaturë

bashkëkohore dhe mjete didaktike që i përgjigjen standardeve ndërkontinentale të mësimdhënies. Qëllimi ishte përmirësimi i cilësisë së arsimit në zonat rurale dhe rritja e




motivimit të nxënësve, me theks të veçantë në mbështetjen e fëmijëve nga komunitetet jo-shumicë që përballen shpesh me vështirësi shtesë në arsimim. Kjo iniciativë përfaqëson një hap konkret drejt barazisë arsimore dhe përfshirjes së komuniteteve në proceset edukative.



### 2. Infrastruktura

Në fushën e infrastrukturës, gjatë periudhës janë përmbyllur me sukses procedurat e prokurimit për dy projekte kryesore në fshatrat Hoçë e Madhe dhe Krushë e Madhe, që synojnë përmirësimin e rrugëve lokale për të lehtësuar qarkullimin dhe përforcuar kohezionin



ndërkomunitar. Pas nënshkrimit të kontratave me kompanitë fituese, pritet që punimet të fillojnë në korrik 2025.

Një rast konkret ishte zgjidhja e problemit të mungesës së kanalizimit për znj. Shutakoviç, anëtare e komunitetit serb, e cila pas më shumë se 15 vitesh është lidhur me rrjetin e kanalizimit lokal. Kjo ndërhyrje tregon qasjen institucionale të orientuar drejt adresimit të nevojave specifike të komuniteteve të kthyer dhe të marginalizuara.

Gjithashtu, ZKKK ka ndërmarrë hapa për përmirësimin e furnizimit me energji elektrike në Lagjen e Epërme, duke paraqitur kërkesa zyrtare dhe iniciuar peticione për vendosjen e trafostacionit të ri, një hap i rëndësishëm për stabilizimin e energjisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në zonë.( KERKESA ESHTË DEPUNUAR NE KEDS , PRITET TE MIRREN MASAT).

## 2. Përfaqësim institucional dhe koordinim ndërkomunal

Një zhvillim i rëndësishëm institucional ka qenë themelimi i Kolegjiumit të 24-të për

Komunitete dhe Kthim në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës, me kryesim të zotit Lendrit Qeli, Shef i ZKKK-së në Rahovec, për një mandat të plotë. Ky kolegium do të shërbejë si forum i rëndësishëm për koordinim, bashkëpunim dhe përfaqësim institucional në nivel komunal dhe ndërkomunal.

3.



## 4. Aktivitetet ndërgjegjësuese dhe trajnime

Gjatë gjashtëmijorit, ZKKK ka organizuar dhe marrë pjesë në një gamë të gjerë aktivitetesh për ngrijen e kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve:

- Trajnime të vazhdueshme mbi procesin e riatdhesimit me përfaqësues të institucioneve dhe komuniteteve të prekura, duke lehtësuar kuptimin e procedurave ligjore dhe administrative për kthimin dhe integrimin e personave të zhvendosur.
- Punëtori mbi mekanizmat kundër dhunës në familje, me fokus në mbrojtjen e grave dhe fëmijëve nga komunitetet jo-shumicë, duke përmirësuar bashkëpunimin ndërinstitucional dhe vetëdijen publike.
- Rekrutimi i përfaqësuesit të komunitetit ashkali në ZKKK, duke e bërë përbërjen e zyrës më gjithëpërfshirëse dhe duke fuqizuar urat e komunikimit me komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe serb.
- Trajnime të organzuara nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe partnerë të tjera mbi të drejtat e njeriut dhe përfshirjen e komuniteteve jo-shumicë.

- Organizim i tryezave dhc takimeve me komunitetet lokale për identifikimin e nevojave specifike dhe promovimin e dialogut ndërkomunitar dhe tolerancës.
- Shpërndarja e materialeve informative në gjuhët e komuniteteve për të irritur informimin dhe përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse



## 5. Planifikimi dhe koordinimi i politikave lokale

ZKKK ka marrë pjesë aktive në punëtori të specializuara të organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Zyrës së Kryeministrit, të cilat trajtojnë zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Veprimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në këto punëtori janë diskutuar ndarja e përgjegjësive ndërinstitucionale dhe përdorimi i shablloneve standarde për raportim.

- Gjithashtu, ZKKK ka bashkëpunuar me sektorë të ndryshëm dhe organizata të shoqërisë civile në mbledhje dhe aktivitete që synojnë koordinimin e mekanizmave kundër dhunës në familje dhe hartimin e planeve të veprimit për adresimin e kësaj sfide në nivel lokal.
- Për më tepër, ZKKK ka qenë pjesë e sesioneve informuese për edukimin e votuesve dhe drejtësinë tranzicionale, duke kontribuar në rritjen e njohurive të komuniteteve jo-shumicë mbi të drejtat demokratike dhe proceset e pajtimit shoqëror.



- Në kuadër të angazhimeve të saj, ZKKK ka mbështetur prezantimin dhe përdorimin e platformës funksionale për raportim dhe komunikim ndërmjet komuniteteve dhe institacioneve, duke siguruar transparencë dhe

përfshirje më të madhe në vendimmarrje.

## 6. Raportim dhe vlerësimi i performancash

Në përputhje me Programin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Njeriut (2021–2025), ZKKK ka hartuar raportin mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjikë për komunitetet jo-shumicë, duke përfshirë pjesëmarrjen në institucionë dhe qasjen në shërbime publike.

- Gjithashtu, është realizuar procesi i vlerësimit të performancës së stafit të ZKKK-së për të rritur përgjegjshmërinë dhe për të identifikuar nevojat për zhvillim profesional dhe përmirësim të shërbimeve.
- Yra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) ka marrë pjesë aktive dhe ka kontribuar në shumë aktivitete të rëndësishme të organizuara nga organizata të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare që punojnë për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë. Konkrektisht, ZKKK ka qenë pjesëmarrëse në aktivitetet e organizatës Roma in Action, ku është diskutuar për përmirësimin e kushteve sociale dhe integrimin e komunitetit rom. Po ashtu, ZKKK ka bashkëpunuar ngushtë me OJQ-në “Zëri i Romeve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve”, duke mbështetur përpjekjet e tyre për fuqizimin e këtyre komuniteteve dhe ngritjen e vetëdijes për të drejtat e tyre.
- Në fushën e medias dhe raportimit etik, ZKKK ka bashkëpunuar me Asociacionin e Gazetarëve të Kosovës për promovimin e raportimit të drejtë dhe profesional mbi komunitetet jo-shumicë, duke u fokusuar veçanërisht në monitorimin e gjuhës së urrejtjes në media dhe nxitjen e një diskursi pa paragjykime. Po ashtu, ZKKK ka qenë e angazhuar



në  
bashkëpunim  
me  
institucionin  
IKAP, në  
aktivitete të  
ndryshme për  
të drejtat e  
komuniteteve  
jo-shumicë,  
duke  
ndihmuar në  
monitorimin  
dhe  
avancimin e  
politikave të  
barazisë dhe  
përfshirjes.  
Përmes


këtyre bashkëpunimeve, ZKKK ka kontribuar në forcimin e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo-shumicë në nivel lokal dhe rajonal.

#### **IV. Pjesëmarrja në struktura vendimmarrëse dhe komitete locale**

Gjatë periudhës janë mbajtur tre mbledhje të Këshillit për Siguri në Bashkësi (KKSBB), ku ZKKK ka prezantuar shqetësimet dhe nevojat e komuniteteve jo-shumicë, duke propozuar masa përmirësimin e sigurisë dhe besimit ndërkomunitar.

Katër mbledhje të Komitetit për Komunitete janë zhvilluar, ku janë harmonizuar prioritetet ndërmjet komuniteteve dhe nivelit ekzekutiv komunal, përfshirë raportimin e aktiviteteve dhc planifikimin për periudhën në vijim.

Gjithashtu, ZKKK ka bashkëpunuar ngushtë me administratën komunale në dy takime dedikuar përmirësimin e shërbimeve dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse.



## V. Përfundim dhe perspektiva për periudhën në vijim

Raporti gjashtëmujor dëshmon për angazhimin e vazhdueshëm të ZKKK-së për të adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojat dhe sfidat e komuniteteve jo-shumicë në Rahovec. Aktivitetet e zhvilluara kanë avancuar integrimin social, përmirësuar infrastrukturën dhe forcuar përfaqësimin institucional.

Në periudhën e ardhshme, prioritet do të jenë finalizimi i projekteve infrastrukturore, zgjerimi i programeve të edukimit dhe ndërgjegjësimit, si dhe përmirësimi i mekanizmave të raportimit dhe bashkëpunimit ndërinstитucional.

ZKKK do të vazhdojë të mbetet një pikë referimi për komunitetet jo-shumicë, duke synuar një zhvillim gjithëpërfshirës dhe përfshirës për të gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit.

Dr.sc. Lendrit Qeli – Udhëheqës i Zyrës  
Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) – Rahovec